



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Nr. Regj. Them. 136
Nr. Vendimit 136

Data e regjistrimit 17.03.2017
Data e vendimit 17.03.2017

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, e përbërë prej:

GJYQTAR: REXHEP BEKTESHI

Asistuar nga sekretare seance **Brunilda Dizdari**, sot më datë 17.03.2017, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen penale Nr. 136 Regj. Them., datë 17.03.2017, me:

KËRKUES: Prokuroria Rrethit Gjyqësor Durrës

OBJEKTI: Vendosjen e sekuestros preventive për shumat e parave të ndodhura në llogaritë me Nr. 00000704227 dhe Nr. 0000808743 në emër të Rivelin Skënder Turku të depozituara në Credins Bank Tiranë dhe të llogarive me Nr. 241659180201 e Nr. 241659180301 në emër të shtetasit Skënder Osman Turku të depozituara në Pro Credit Bank Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 274/1 të Kodit Procedurës Penale.

U thirr dhe u paraqit në gjykim **prokurorja e çështjes Enkeleda Xhengo**, që në përfundim të shqyrtimit gjyqësor i kërkoi gjykatës: Pranimin e kërkesës dhe vendosjen e sekuestros preventive për shumat e parave të ndodhura në Llogaritë me numër 00000704227 dhe Nr. 0000808743 në emër të [REDAKTUAR] dhe të depozituara në Credins Bank Tiranë dhe të llogarive me Nr. 241659180201 e Nr. 241659180301

në emër të shtetasit [REDAKTUAR] të depozituara Pro Credit Bank Tiranë, në zbatim të nenit 274 të Kodit Procedurës Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi materialet e çështjes,

V Ë R E N

Se nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës po kryhen hetime në ngarkim të shtetasit [REDAKTUAR] i dyshuar për veprat penale të “Pastrim të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” në bazë të nenit 287 të Kodit Penal dhe nga hetimet kryera del se shtetasi i mësipërm është i përfshirë në veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve” që parashikohet nga neni 283/a të Kodit Penal.

Organi i Prokurorisë në kërkesën e bërë argumenton se nga kjo veprimtari e paligjshme, shtetasi [REDAKTUAR] ka siguruar të ardhura në para (lekë) e monedha të huaja në shuma të mëdha që i ka transferuar në bankë, me qëllim mbulimin e origjinës së paligjshme të tyre.

Rezulton se shtetasja [REDAKTUAR] ka bërë tre transfertat bankare në shoqërinë “[REDAKTUAR]” sh.p.k. me administrator shtetasin [REDAKTUAR] si dhe në emër të personit fizik shtetasit [REDAKTUAR] dhe transfertat në total janë në shumën 903.500 dollarë amerikan.

Në hetim janë kërkuar informacionet përkatëse nga bankat e nivelit të dytë që operojnë në vendin tonë lidhur me llogaritë bankare që janë në emër të shtetasit Rivelin Turku dhe të familjarëve të tij.

Nga Shkresa me Nr. 10286/1 Prot., datë 13.03.2017 e Credins Bank Tiranë, del se në llogarinë e tij me numër 00000704227 ka gjendje llogarie në shumën 14.408.584 lekë, ndërsa në llogarinë me numër 0000808743, ka gjendje llogarie në shumën prej 80.000,04 lekë.

Po kështu, del se nga Shkresa me Nr. 2117, datë 03.03.2017 e Pro Credit Bank Tiranë, shtetasi Skënder Turku që është babai i Rivelin Turku ka llogari bankare me numër 241659180201, në shumën 5.623,45 lekë dhe llogari bankare me numër 241659180301 në shumën 1.000.000 lekë.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka kërkuar vendosjen e sekuestros preventive mbi shumat e mësipërme që ndodhen të depozituara në llogaritë bankare të mësipërme, me qëllim realizimin e një hetimi të plotë të çështjes penale.

Gjykata shqyrtoi materialet e çështjes dhe vlerëson që nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës po kryhen hetime për një vepër penale me rrezikshmëri shoqërore

që është shumë e përhapur, e për sigurimin e plotë të provave e realizimin e një
në plotë e objektiv të çështjes penale, kërkesa e bërë prej Prokurorisë duhet
pasqyruar pasi është e mbështetur në prova e në ligj.

PËR KËTO ARSYE

Zbatim të nenit 274 të Kodit Procedurës Penale, Gjykata:

V E N D O S I

1. Pranimin e kërkesës të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Vendosijen e sekuestros preventive për shumat e parave të ndodhura në llogaritë me Nr. 00000704227 dhe Nr. 0000808743 në emër të [REDAKTUAR], të depozituara në Credins Bank Tiranë, si dhe të llogarive me Nr. 241659180201 e Nr. 241659180301 në emër të shtetasit [REDAKTUAR] të depozituara në ProCredit Bank Tiranë.
3. Një kopje të këtij vendimi i dërgohet organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për zbatim.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Durrës brenda 10 itëve nga e nesërmja e shpalljes.

U shpall në Durrës më datë 17.03.2017.

GJYQTAR

REXHEP BEKTESHI




-Me vendimin Nr. 10-2018-385/30, datë 21.02.2018 të Gjykatës së Apelit Durrës është vendosur:


“Lënien në fuqi të vendimit penal nr. 136, datë 17.03.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.”

Konceptoi.Herris Kazazi



**KRYESEKRETARE
MARSIDA SHULLANI**



Nr.1
Dat

Asi
BY
14.

KË

PA

OI

B/

GI
AI
AI